Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA
Pranuar / Primljeno Me-Dana 21-01-2026
01-060/01-119

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/15, Qershor 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të Nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL), Nr 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunës, në Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës se Vitisë, nr 01-013/594, e datës 02.05.2014, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

# F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **II** të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datë **30.01.2026, (e premte),** duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë, në shtëpinë e kulturës, "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

## R e n d d i t e

**1. a) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Kuvendit Komunal;**
**b) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit Komunal.**
**2. Informatë (Raport) e punës së Kryetarit të Komunës së Vitisë për periudhën janar-dhjetor 2025.**
**3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete.**
**5. Propozim për shqyrtimi dhe miratimin e iniciativës së kryetarit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës së Vitisë me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011.**
**6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e komisionit për ndryshim plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011.**
**7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për forminim e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës.**
**8. a) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për nismën e kryetarit të Komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Komunës së Saint Julien en Genevois;**
**b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Komunës së Saint Julien en Genevois.**
**9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratim të dy anëtarëve të komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve për institucionet edukativo arsimore të nivelit, parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në komunën e Vitisë.**

**Viti, më 21.01.2026**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Bekim Azizi**

PIKA 1 a) E RENDIT TË DITËS

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

# PROCESVERBAL

## I MBLEDHJES INAUGURUESE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi kryetari, z.Sokol Haliti, ndërsa atë e kryesoi, z.Basri Aliu anëtari më në moshë i Kuvendit Komunal të Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 09.12.2025 (e martë), në shtëpinë e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani", duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: këshilltarët e Kuvendit, z.Basri Aliu, z.Ramadan Deliu, z.Zejnepe Osmani, z.Ilir Zuka, z.Ekrem Ymeri, z.Sokol Shaqiri, z.Bekim Rama, z.Faruk Shabani, znj.Milihate Ajeti, znj.Diellza Fejzullahu, z.Bekim Azizi, z.Hajdin Ademi, z.Nuhi Ramadani, z.Visar Demiri, z.Selim Sejdiu. znj.Elsa Jahija, znj.Ardita Hajdari, znj.Mirjeta Hamiti, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Remzi Salihu, znj.Lindita Demelezi, znj.Majlinda Shabani, z.Ekrem Abazi, z.Lulzim Haxhiu, z.Labinot Bislimi, z.Elham Emerllahu.

**Kryetari z. Sokol Haliti:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën inauguruese! Të nderuar të pranishëm, ju anëtarë të Kuvendit të Komunës së Vitisë, bazur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, e kemi thirrë këtë seancë inaguruese në afatet ligjore. Pa humb kohë ftoj sekretarin e kuvendit ta fton anëtarin më të moshuar për ta udhëhequr këtë seancë inaguruese, por para se me ftu, ju ftoj për nder të dëshmorëve, të veprimtarëve e të atyre që nuk janë në jetë ta mbajmë një minut heshtje, në shej të nderimit për të gjithë. Lavdi! Ftoj sekretarin me e ftu më të moshuarin.

**z.Fatlum Demiri nga sekretaria e kuvendit:** Faleminderit kryetar për fjalën e dhënë! Të nderuar të pranishëm, bazuar në nenin 42 të paragrafi 42.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në të cilin thuhet se: anëtari më në mosh e kryeson seancën inaguruese, bazuar në këtë dhe të dhënat që posedojmë në Zyrën e Sekretarisë së Kuvendit, konstatojmë se: anëtari me në moshë është, z.Basri Aliu, të cilin e ftojmë ta kryeson këtë seancë, ndërsa anëtarja më e re në mosh është znj.Elsa Jahija, të cilën e ftojmë të ju bashkëngjitet Basrisë.

**z.Basri Aliu, kryesues i seancës inauguruese:** Të nderuar të pranishëm, më lejoni të ju përshëndes të gjithëve që jeni prezent, fituesve të zgjedhjeve, urime për fitoren. Nga partitë politike kërkojm nga një anëtar që të formojmë komisionin për verifikimin e mandateve të anëtarëve të kuvendit. Nga LDK-ja kanë e propozoni? Z.Ilir Zuka. Nga PDK-ja Visar Demiri, nga LVV-ja, znj.Majlinda Shabani. I ftoj të konsultohen me sekretarin e kuvendit.

**z.Fatlum Demiri nga sekretaria e kuvendit:** Me kërkesën e anëtarëve të komisionit për verifikimin e komandantëve lexojmë këtë. Komisioni për verifikimin e mandateve, i themeluar nga Kuvendi i Komunës, bazuar në nenin 35, paragrafi 35.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 të Republikës së Kosovës, komisioni për verifikimin e mandateve, duke pasur për bazë Vendimin e komisionit qendror zgjedhor Nr.01/3376-2025, të datës 21 nëntor 2025, për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve në Republikën e Kosovës për Kuvendet Komunale të mbajtura me 12 tetor 2025, konkretisht të Kuvendit Komunal të Vitisë, konstatojmë që këta janë anëtarët e Kuvendit Komunal të Vitisë për këtë mandate. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK): Sokol Shaqiri, Milihate Ajeti, Basri Aliu, Ilir Zuka, Ramadan Deliu, Ekrem Ymeri, Bekim Rama, Djellza Fejzullahu, Zejnepe Osmani, Faruk Shabani. Partia Demokratike e Kosovës (PDK): Bekim Azizi, Hajdin Ademi, Nuhi Ramadani, Visar Demiri, Selim Sejdiu, Elsa Jahija, Ardita Hajdari, Mirjeta Hamiti. Lëvizja Vetëvendosje (VV): Majlinda Shabani, Ekrem Abazi, Remzi Salihu, Jakup Demiri, Lindita Demelezi, Liridona Bislimi, Lulzim Haxhiu. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK): Labinot Bislimi. Nisma

Socialdemokrate (NISMA), Elham Emërllahu. Kryesues, këta janë anëtarët e kuvendit të cilët janë zgjedhur. Mund të vazhdoni me procedurat e dhënies së betimit.

**z.Basri Aliu, kryesues i seancës inaguruese:** Lus anëtarët e kuvendit që të ngritën në këmbë. Unë e lexoj tekstin e betimit, ju e përcjellni dhe e nënshkruani. Bazuar në nenin 35, paragrafi 35.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 24, paragrafi 24.6 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, neni 4 i Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, dhe në bazë të Vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor Nr.01/3376-2025, të datës 21 nëntor 2025, për çertifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendet Komunale të mbajtura me 12 tetor 2025, të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet ta nënshkruajnë betimin solemn si në vijim:

Unë, Basri Aliu, ***"Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anësi dhe me ndërgjegje, sipas ligjit, detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Vitisë, në mënyrë që të sigurohen kushte për një jetë të qetë për të gjithë."***

Tani ftoj kryetarin e komunes që ta jap betimin para juve.

**Kryetari z.Sokol Haliti:** Urime për përbërjen e re të Kuvendit Komunal të Vitisë. Të nderuar qytetarë të Komunës së Vitisë, të nderuar të pranishëm, faleminderit që jeni prezent në këtë seancë. Sot do të bëjë betimin para juve.

**Sekretaria:** Fillimisht kryetari e mbajti një fjalim rasti që i falënderoj te gjith qytetarët e Komunës së Vitisë pa përjashtime. Pasi mbajtjes së fjalimit kryetari bënë betimin.

Unë, Sokol Haliti, ***"Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anësi dhe me ndërgjegje, sipas ligjit, detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Vitisë, në mënyrë që të sigurohen kushte për një jetë të qetë për të gjithë."***

Së bashku do të vazhdojmë me punë të mira. Zoti e bekoftë Komunën e Vitisë!

Mbledhja përfundoi me punë në ora 10:30 min.

| | |
|---|---|
| **Procesmbajtësi:** | **Kryesuesi i mbledhgjes se Kuvendit Komunal:** |
| **Fatlum Demiri** | **Basri Aliu** |
| ________________ | ________________ |

PIKA 1 b) E RENDIT TË DITES

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

# PROCESVERBAL

## I MBLEDHJES E PARË TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi kryetari, z.Basri Aliu, kryesuesi i seancës se Kuvendit Komunal. Mbledhja është mbajtur më 08.01.2026 (e enjte), në shtëpinë e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani", duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: këshilltarët e Kuvendit, z.Basri Aliu, z.Ramadan Deliu, z.Zejnepe Osmani, z.Ilir Zuka, z.Ekrem Ymeri, z.Sokol Shaqiri, z.Bekim Rama, z.Faruk Shabani, znj.Yllka Qamili, znj.Djellza Fejzullahu, z.Bekim Azizi, z.Hajdin Ademi, z.Nuhi Ramadani, z.Visar Demiri, z.Selim Sejdiu. znj.Elsa Jahija, znj.Ardita Hajdari, znj.Mirjeta Hamiti, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Remzi Salihu, znj.Lindita Demelezi, znj.Majlinda Shabani, z.Ekrem Abazi, z.Lulzim Haxhiu, z.Elham Emërllahu, ndërsa mungoi z.Labinot Bislimi.

**Kryesesui i Kuvendit, Basri Aliu:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e parë të rregullt! Përshendejte për të gjithë të pranishmit që janë në këtë seancë. Kjo është seanca e parë e Kuvendit Komunal të këtij mandati. Gjithashtu ju uroj të gjithëve festën e vitit të ri. Pasi që si kuvend nuk kemi pas takim, por edhe të gjithë qytetarët e Vitisë të ju dëshirojmë një vit sa më të mbarë dhe të suksesshëm. Para se të kalojmë në rend dite. Paraprakisht kemi një propozim vendim si pikë shtesë, dhe në bazë të votimit të juaj ta shofim a do të hy si rend dite. Propozim vendim, themelimi i drejtorisë komunale, Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, që do të bëhen këto ndryshime. Është ky propozim që të hyjë në rend të ditës. Ju kisha pyet të gjithëve anëtarëve të asambles, që me votim a jeni për miratimin që të hyjë në rend dite kjo pikë. Pra, e qes në votim. Me 18 vota pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, kjo pikë hynë në rend të ditës. Për këtë seancë kemi parpa këtë:

## Rend dite

1. **Dhënia e betimit të anëtares se Kuvendit të Komunës znj. Yllka Qamili.**
2. **Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.**

**Si pikë shtesë hynë:**

**3. Propozim vendim për themelimin e drejtorisë komunale, Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtorinë për Siguri dhe Emergjencë.**

**Kryesesui i Kuvendit Basri Aliu:** A jeni që të miratohet ky rend dite? Pra, me 19 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim miratohet dhe rendi i ditës.

**Si pikë e parë e rendit të ditës:**

**1. Dhënia e betimit të anëtares së Kuvendit të Komunës, znj.Yllka Qamili**

**Znj.Yllka Qamili:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë Yllka Qamili betohem se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje, dhe sipas ligjit detyrat, dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtare i Kuvendit të Komunës së Vitisë, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë. Betohem!

**Si pikë e dytë e rendit të ditës:**

**2. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës**

**Kryesuesi i Kuvendit, Basri Aliu:** Për këtë pikë duhet të formohet një komision prej 3 anëtarëve të kuvendit. Ju kisha lutë grupeve parlametare ta jepni propozim, që të zgjidhet ky komision.

**z.Ilir Zuka:** Ne si grup parlamentar i LDK-së e propozojmë, Yllka Qamilin.

**z.Visar Demiri:** Ne si grup parlamentar i PDK-së propozojmë Ardita Hajdarin.

**z.Ilir Zuka:** Gjithashtu unë propozoj që të jetë përfaqësuesi i Nismës, pjesë të komisionit.

**Kryesesui i Kuvendit, Basri Aliu:** Po e pyes kuvendin: a jeni për këta 3 anëtarë të komisionit? Pra, me të gjithë pro, pa asnjë kundër, asnjë abstenim përbëhet ky komision dhe fillon punën për zgjdhjen.

**z.Ilir Zuka:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Ne si grup i LDK-së nuk kemi propozim, por ja lëmë propozimin partisë së kualicionit, PDK-së që ta bëjë propozimin për kryesues të Kuvendit Komunal të Vitisë.

**z.Visar Demiri:** Të nderuar të gjithë të pranishmit, në emër të grupit parlamenetar të PDK-së propozojmë Bekim Azizin për kryesues të Kuvendit Komunal, profesor, ish kryesues i Kuvendit Komunal dhe këshilltar komunal në mandate të kaluara.

**Kryesesui i Kuvendit, z.Basri Aliu:** Pasi që nuk ka propozim tjetër, vazhdojmë me procedurat tjera. Pasi që jemi gati, i lus anëtarët e komisioni, që t'i thirr me emera anëtarët e kuvendit që votojnë.

**Yllka Qamili, anëtare e komisionit:** Sokol Shaqiri, Basri Aliu, Ilir Zuka, Ramadan Deliu, Ekrem Ymeri, Bekim Rama, Diellza Fejzullahu, Zejnepe Osmani, Faruk Shabani, Yllka Qamili, Bekim Aziz, Hajdin Ademi, Nuhi Ramadani, Visar Demiri, Selim Sejdiu, Elsa Jahija, Ardita Hajdini, Mirjeta Hamiti, Majlinda Shabani, Ekrem Abazi, Remzi Salihu, Jakup Demiri, Lindia Demelezi, Liridona Bislimi, Lulzim Bislimi, Labinot Bislimi, Elhamni Emërllahu.

**z.Fatlum Demiri nga sekretaria e kuvendit:** Të nderuar të pranishëm, më lejoni të ju njoftoj se, kryesuesi i kuvedit komunal zgjidhet me shumicën e votave të atyre që janë prezent dhe që votojnë. Në rastin konkret, Kuvendi Komunal i Vitisë i ka 27 anëtarë. Nëse kryesuesi arrin me i marr 14 vota për, në rundin e parë zgjedhet kryesus i Kuvendit Komunal. Tani ftoj komisionin që të jet transparent dhe t'i numëroj votat para anëtarëve të kuvendit.

**Kryesesui i Kuvendit, z.Basri Aliu:** Pjesmarrës në votim i kemi 19 anëtar të kuvendit.

**znj.Yllka Qamili, anëtare e komisionit:** Pas rezultateve te votimit konstatojmë se, 19 anëtar kanë qenë pjesëmarrës në votim, 18 kanë votu për 1 ka qenë kundër.

**Kryesesui i Kuvendit, z.Basri Aliu:** Me lejoni që ta ftoj kryesuesin e kuvendit dhe ta uroj për detyrën e re.

**z.Bekim Azizi, kryesusi i Kuvendit Komunal:** Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, i nderuar kryetar, të nderuar të pranishëm. Jam shumë falenderues prej secilit për besimin që më dhatë për të udhëheq Kuvendin Komunal edhe për këtë mandat. Ju uroj të gjithve mandatin që e keni fitu, uroj që të na shkojnë mbarë. Do t'i respektojmë ligjet, rregulloret e këtij vendi.

**Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:**

**3. Propozim vendim për themelimin e drejtorisë komunale, Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtorinë për Siguri dhe Emergjencë**

Pas arsyetimit të dhënë nga kryesuesi i kuvendit që e dha më parë: a ka diskutim për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka diskutim: a jeni që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Me 19 vota pro, zero kundër, zero abstenim nuk ka miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Faleminderit nga të gjithë për kontributin e dhënë në këtë seancë.

Mirëupafshm në seancën e radhës!

Mbledhja përfundoi me punë në ora 10:30 min

**Procesmbajtësi:**
**Fatlum Demiri**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**
**Bekim Azizi**

PIKA 2 E RENDIT TË DITËS

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosova

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA
Pranuar/Primljeno Më/Dana 21-01-2026
Nr. i Organit / Org. Broj: 07 | Numri/Broj: 016/01 | Shtojce e Prilogi: – | Vlera/Vrednost: 120

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitina

***Informatë (Raport) e punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar – dhjetor 2025***

***Viti, Janar 2026***

# PËRMBAJTJA

KAPITULLI I

Përmbledhje ekzekutive ........ 3
- Hyrje ........ 3

KAPITULLI II

Raportët e Zyrave të Kryetarit ........ 4
- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ........ 4
- Njësia për Auditim të Brendshëm ........ 6
- Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete ........ 6
- Zyra për barazi Gjinore ........ 6
- Zyra Ligjore ........ 7
- Zyra për Avokatin Publik ........ 8
- Zyra për Prokurimi ........ 9
- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun ........ 10
- Zyra për Integrime Evropiane ........ 11

KAPITULLI III

Raortët e Drejtorive ........ 12
- Drejtoria për Administratë ........ 12
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim ........ 16
- Drejtoria për Arsim ........ 17
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë ........ 22
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqënie Sociale ........ 27
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ........ 45
- Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi ........ 57
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ........ 58
- Drejtoria për Inspeksion ........ 60

# KAPITULLI I

## Përmbledhje

Raporti për vitin 2025 i Kryetarit të Komunës së Vitisë dhe organeve komunale përmban një analizë të detajuar të aktiviteteve, arritjeve dhe sfidave të përballuara gjatë periudhës së raportimit. Ky raport pasqyron përpjekjet dhe rezultatet e arriura në fusha kryesore të zhvillimit ekonomik, infrastrukturës, arsimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale si dhe kulturës dhe sportit. Ai përfshin gjithashtu rekomandime dhe plane për përmirësimet e ardhshme, bazuar në analizën e të dhënave dhe adresimet e qytetarëve dhe grupet tjera të interest.

## Hyrje

Paraqitja e raportit vjetor për vitin 2025 është një proces i rëndësishëm i llogaridhënies institucionale dhe një mundësi e vlefshme për të reflektuar mbi angazhimet, vendimet dhe veprimet që kanë shënuar punën e Komunës së Vitisë gjatë këtij viti. Ky raport synon të ofrojë një pasqyrë të qartë, të strukturuar dhe reale mbi gjendjen aktuale të komunës, rezultatet e arritura si dhe sfidat që kanë shoqëruar proceset zhvillimore.

Gjatë vitit 2025, qeverisja komunale ka qenë e orientuar drejt përmbushjes së objektivave strategjike dhe planeve zhvillimore afatmesme, me fokus të veçantë në përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët tanë. Përmes një menaxhimi të përgjegjshëm të burimeve financiare dhe njerëzore, janë realizuar projekte të rëndësishme që kanë ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin e infrastrukturës, në rritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe në forcimin e kapaciteteve institucionale.

Raporti përfshin një pasqyrim të detajuar të aktiviteteve dhe investimeve në sektorë kyç si infrastruktura rrugore dhe komunale, arsimi, shëndetësia, mirëqenia sociale, zhvillimi ekonomik lokal dhe mbështetja për ndërmarrjet vendore. Po ashtu, janë paraqitur edhe iniciativat në fushën e mbrojtjes së mjedisit, planifikimit hapësinor dhe digjitalizimit të shërbimeve, të cilat synojnë krijimin e një administrate më efikase dhe më të afërt me qytetarin.

Një pjesë e rëndësishme e këtij raporti i kushtohet gjithashtu sfidave të hasura gjatë vitit 2025, përfshirë kufizimet buxhetore, rrethanat ekonomike dhe kërkesat në rritje të qytetarëve për shërbime më cilësore dhe më të shpejta. Këto sfida janë adresuar me përkushtim, përmes planifikimit më të mirë, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përfshirjes aktive të Kuvendit Komunal në proceset vendimmarrëse.

Ky raport nuk është vetëm një dokument informues, por një bazë për dialog të hapur, analizë të përbashkët dhe përmirësim të vazhdueshëm të qeverisjes lokale. Bashkëpunimi, transparenca dhe llogaridhënia mbeten shtyllat kryesore mbi të cilat ndërtojmë besimin e qytetarëve dhe funksionimin demokratik të institucionit tonë.

Me një vizion të qartë për të ardhmen, Komuna e Vitisë mbetet e përkushtuar ndaj zhvillimit të qëndrueshëm, krijimit të mundësive për rininë, përkrahjes së iniciativave ekonomike dhe ruajtjes së një mjedisi të shëndetshëm dhe të sigurt për të gjithë banorët. Jam i bindur se, përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe angazhimit të përbashkët, do të vazhdojmë të ndërtojmë një Komunë të Vitisë më të zhvilluar, më funksionale dhe më gjithëpërfshirëse.

# KAPITULLI II

## Raportët e Zyrave të Kryetarit

## Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Mbështetur në objektivat, qëllimet dhe kompetencën ligjore që ka NJMBNJ-ja me përshkrim, në pika të shkurta paraqesum këtë raport të punës për periudhën janar - dhjetor 2025. Gjatë periudhës janar – dhjetor 2025 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka kryer punët në bazë të komptencave dhe autorizimeve të cilat dalin nga Ligji për Zyrtarët Publik, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin e Punës, Ligjin mbi Pagat, Ligjin mbi Administratën Shtetrore, Ligjin e Punës si dhe aktet tjera nënligjore: Statuti i Komunës dhe Vendimi mbi Organizimin e Organeve Komunale dhe aktet tjera nënligjore të cilat rregullojnë fushënn e marrëdhënies së punës.

Për vitin 2025, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me kryetarin e Komunës ka hartuar planin e personelit në bazë të udhëzimeve të cilat janë dhënë nga Ministria e Administratës Publike - Departamenti i Shërbimit Civil si dhe drejtoritë përkatëse, në veçanti me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Mbështetur në këtë kemi klasifikuar këto aktivitete:

**Konkurset dhe zhvillimi i procedurave të konkursit**

Mbështetur në planin e punës së NJMBNJ-së si dhe duke u mbështetur në kompetencat ligjore, NJMBNJ në pajtim me ligjin dhe aktet normative ka zhvilluar procedurat e konkurseve të brendshme, ngritje në detyrë apo lëvizje paralele. Të gjitha procedurat e konkurseve janë zhvilluar falë bashkëpunimit me drejtoritë përkatëse të Komunës së Vitisë, përkatësisht zyrtarëve të drejtorive përkatëse si dhe falë bashkëpunimit të komisionve rekrutuese, të cilët kanë qenë të pavarur në punë dhe ju kemi ofruar ndihmë profesionale teknike.

Mbështetur në këtë paraqesum aktivitetet e rekrutimit apo pranimit në punë të punëtorëve na pajtim me planin e punës, duke i radhitur aktivitetet sipas drejtorive komunale:

**Drejtoria për Inspeksion, këto pozita:**

Duke u mbështetur në Ligjin për Zyrtar Publik si dhe duke u mbështetur në kërkesat e Drejtorisë Komunale të Inspekcionit në Viti, NJMBNJ-ja ka shpallur konkurs dhe ka rekrutuar pozitën Inspektor i Shërbimeve Publike dhe Inspektor i Komunikacionit në të cilat kanë konkuruar 31 kandidatë, ndërsa janë pranuar dy (2) kandidat. Për të gjitha këto pozita procedura e rekrutimit është kryer sipas Ligjit për Zyrtar Publik dhe Rregullorës për Pranim dhe Karrier në Shërbimin Civil.

**Drejtoria për Arsim, këto pozita:**

Duke u mbështetur në Ligjin për Zyrtar Publik si dhe duke u mbështetur në kërkesat e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Viti, NJMBNJ-ja ka shpallur konkurs për personelin arsimor. Brenda periudhës janar - dhjetor 2025, NJMBNJ-ja ka shpallur në muajin Maj për pozitat Drejtor të Shkollave, në muajin Maj është shpallur konkursin për staf mësimdhënës me kohë të caktuar, Konkursi për Edukatore për grupmosha 0-3 dhe 3-6 është shpallur por i njejti është anuluar, konkursi i rregullt për staf mësimdhënës është shpallur në muajin Korrik e i cili është anuluar, ndërsa gjatë muajit Korrik janë shpallur pozita Psikolog dhe Mësidhënës, në muajin Tetor është shpallur konkursi këshilltar i karrierës dhe një konkurs për mësimdhënës me kohë ta caktuar për 36 pozita është shpallur dhe i njejti ka përfunduar i sukseshëm ku kanë aplikuar 114 kandidatë dhe gjatë viti 2025 kemi shpallur katër (4) konkurse për pozitën punëtor teknik.

Nga të dhënat që posedojmë, në këto konkurse dhe vlersimiet e komisioneve të formuara nga Drejtoria e arsimit, duke përfshirë personel udhëheqës (drejtorë shkollash), personel mësimdhënës (professor/eshë lëndor,

mësimdhës lëndor 6-9, mësimdhënës klasor 1-5, edukator/e), staf mbështetës (punëtor teknik). Pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit për pozitat e kërkuara në konkurs, janë pranuar në punë 66 persona.

- Mësimëdhënës janë pranuar 17;
- Drejtor i shkollës janë pranuar (2) drejtor
- Transfere për Mësimëdhënës 5 pozita dhe
- Punëtor teknik janë pranuar 4 punëtor teknik.

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, këto pozita:**

Në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – QKMF, në konkursin për mjek të përgjithshëm kanë aplikaur 15 kandidatë, ndërsa janë pranuar 5 kandidatë, Kontrata e punës aktualisht janë në procedurë të nënshkrimit. Kurse në DSHMS-së - Qendra për Punë Sociale, kemi pasur një konkurs për pozitën Zyrtar për çështje Psikologjike, ku procedura është në fazën e publikimit të rezultatave, për të cilat pozita është shpallur konkursi publik dhe procedura e rekrutimit është kryer sipas Ligjit për Zyrtar Publik.

**Drejtoria për Financa, këto pozita:**

Në Drejtorinë për Financa, në konkursin për pozitën Udhëheqës i sektorit të zhvillimit ekonomik kanë aplikuar 15, ndërsa është pranuar një (1) kandidatë e ku procedura është në fazën e publikimit të rezultatave, në konkursin për pozitën zyrtar i lartë Pasurisë kanë aplikaur 19 kandidatë, ku procedura është në fazën e publikimit të rezultatave ndërsa në Sektorin e Tatimit në Pronë për pozitën zyrtar për evidentimin e pronës së pajutshme kanë aplikuar 26 kandidatë, është pranuar një (1) kandidatë e ku procedura është në fazën e publikimit të rezultatave,për të cilat pozita është shpallur konkursi publik, e i cili është kryer sipas Ligjit për Zyrtar Publik.

**Mjetet juridike dhe shqyrtimi i tyre**

Duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi, e drejta për shfrytëzim të mjeteve juridike në procedurë administrative është parim primar, prandaj mbështetur në këtë, gjatë fazës së rekrutimit si dhe punës së përditshme të Njësisë për Menaxhimin e Burimve Njerëzore, palët në procedurë administrative kanë shfrytëzuar mjetet jurike. Mbështetur në kompetencë, këtyre mjeteve u janë përgjigjur komisionet e ankesave në afat ligjor:

- Komsioni për nëpunësit e shërbimit publik (Arsim dhe Shëndetësi) ka shqyrtuar 15 ankesa dhe të cilat janë refuzuara si të pabazuara;
- Vendime të shkuarjes në pension dhe lirim nga shërbimi civil të 5 (pesë) zyrtarve të shërbimit civil, përpiluar nga NJMBNJ-ja;
- Vendim për pensionim të parakohshëm ( 3 zyrtar ) me 70% të pagesë.

Gjithashtu janë kryer edhe vendime, shkresa të ndryshme rutinë që janë natyrë e punës administrative dhe zyrtare.

**Vlerësimi i performancës (rezultate në punë) së zyrtarëve publik**

Në kordinim me drejtoritë përkatëse, për të gjithë zyrtarët publik është bërë vlerësimi i rezultatev të punës konform rregullave që janë në fuqi. Ky proces është bërë duke rrespektuar rregullat, ku mbikëqyerësit të drejtpërdrejt kanë vlerësuar rezultatet në punë të zyrtarëve të tyre, në kuadër të departamentit përkatës. Kurse NJMBNJ-ja ka monitoruar dhe ka sistemuar vlerësimet në dosjet e tyre personale.

Gjatë vitit 2025 vëmendje ju është kushtuar **nevojave për trajnimin** e nëpunësve civil ekzistues dhe nëpunësve të rinj. Në bashkëpunim me IKAP-in janë mundësuar trajnime për profilet përkatëse tek nëpunësit ekzistues dhe trajnimi hyrës për nëpunës të rinj.

**Dosjet Individuale** elektronike për nëpunës të shërbimit publik dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës janë përpunuar gjatë vitit 2025, duke u ngarkuar dokumente relevante të secilit nëpunës, ndërsa dosjet individuale elektronike për shërbimin civil janë përpunuar dhe plotësuar edhe gjatë vitit 2025.

Njësia për Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka përpiluar planin e personelit për vitin 2026 përmes SIMBNJ/HRMIS. I njëjti është dërguar për aprovim tek udhëheqësi më i lartë administrativ për aprovim. Pas aprovimit i njëjti është dërguar në DMZP në Prishtinë.

Ku raport është punuar në përputhje me nenin 16, paragrafi 4 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr.08/L197.

## Njësia për Auditim të Brendshëm (NJAB)

Njësia për Auditim të Brendshëm gjatë vitit 2025 ka pasë të planifikuar 4 auditime dhe ka realizuar gjithashtu 3 auditime.

## Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komuniteteve

Gjatë periudhës kohore është bërë monitorimi dhe raportimi i ligjeve që janë në funksion të të drejtave të njeriut, janë organizuar takime me organizatat joqëveritare që punojnë në këtë fushë, janë mbajtur fushata ndërgjegjësimi me komunitetin e gjërë, duke përfshirë rininë shkollore e disa takime tjera për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitëtëve për vitin 2024, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës ka hartuar planin e punës, gjithashtu edhe në bazë të udhëzimeve të cilat janë dhënë nga Ministria për Administratë Publike, Departamenti i Shërbimit Civil si dhe drejtoritë përkatëse, në veçanti me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitëtëve ka patur vazhdimisht kontaktë me avokatin e popullit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në rajonin e Gjilanit, i cili vazhdimisht ka qënë prezent për kërkesat që janë paraqitur për shqyrtim. Gjatë kësaj periudhe njëvjeçare janë paraqitur 8 rastë të cilat i ka shqyrtuar avokati i popullit, dhe i ka rekomandur për të drejtat e tyre të cilat kanë menduar se u janë shkelur. Rastë kemi patuar për të drejtat e njerit me personat me aftësi të kufizuar për punësim, pasi që ligji e precizon në bazë të numrit të punësuarve në institucionin tonë të ketë persona me aftësi të kufizuar. Kryetari ka marrë iniciativën që të respektohet kuota e punësimit për këtë katëgori, ku edhe është vepruar.

Përveç kësaj, ne si zyre kemi patur disa trajnime me organizata të huja lidhur me të drejtat e njeriut, siç janë OSBE-ja, grupi i grave për barazi gjinore. Temat të cilat janë debatuar nëpër trajnime të ndryshme kanë qënë: "Higjiena e mediave në raportim për ekstremizëm dhe radikalizëm".

Kjo zyre vazhdimisht ka komunikuar me zyrtarët e kësaj njësie për rastët të cilat i kanë pasur gjatë ushtrimit të funksionit, si për shembull Zyra për Barazi Gjinore ka zhvilluar disa aktivitëtë nëpër shkolla si të evitohet dhuna në familje.

Planin e veprimit, i cili plan është hartuar në bashkëpunim me ekspert ndërkombëtar me disa takime pune, ku ky plan i ka përmbajtur të gjitha procedurat deri në aprovimin nga kuvendi komunal, ku në këtë plan të veprimit trevjeçar të gjitha drejtoritë kanë paraqitur rastët e tyre të cialt kanë nevojë për trajtime. Plani i veprimit i hartuar nga komisioni i cili është zgjedhur nga ana e Kryetarit të Komunës vazhdimisht kane paraqitur sfidat e tyre që po ballafaqohen gjatë zbatimit të ktij plani.

## Zyra për Barazi Gjinore

Në raport janë prezantuar aktivitëtët të cilat pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatët e shënuara përgjatë periudhës janar – dhjetor 2024, ku prej tyre veçojmë:

- Monitorimi i ligjeve të aplikueshme në funksion të barazisë gjinore nga institucionet komunale dhe harmonizimi i aktëve normative.
- Organizimi i fushatës "Java e edukimit për Barazi Gjinore", ku në kuadër të kësaj fushatë është organizuar një tryezë me aktërët përgjegjës me tëmën " Progresi i arritur për Barazi Gjinore dhe sfidat për të ardhmen, dhe njëkohësisht gjatë periudhës 01- 08 mars janë mbajtur aktivitëtë të shumta në shënimin e Ditës ndërkombëtare të gruas.

- Organizimi i trajnimit me gratë fermere të komunës së Vitisë për rolin dhe rëndësinë e marketinguttë bizneset bujqësore, i cili u organizua nga Drejtoria e Bujqësisë dhe organizata KDC.
- U nënshkrua marrëveshje bashkëpunimi në mes të Komunës së Vitisë dhe USAID-it për realizimin e projektit për të drejtat pronësore, me theks të drejtat e grave në pronë, ku në kuadër të këtij projekti parashihen aktivitëtë të ndryshme me komunitëtin e gjërë të komunës.
- Për promovimin e aktivitëtëve të realizuara për avancimin e barazisë gjinore, Vitia në muajin qërshor u përfaqësua në konferencën ndërkombëtare me tëmë: "Roli i burrrave në avancimin e barazisë gjinore", ku morri pjesë nënkryetari i Komunës së Vitisë.
- Me 6 qërshor, në bashkëpunim me NDI, u mbajt një tryezë diskutimi, me tëmë "fuqizimi i grave në zonat rurale, ku morrën pjesë 30 pjesmarrëse gra/vajza nga të gjitha zonat e Komunës së Vitisë
- Organizimi i takimit për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, forma e procedurave së aplikimit për përfitimin e pensioneve për këtë katëgori organizuar nga QPDG.
- Caktimi i indikatorve raportues për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe raportimi në ZKM/ZQM për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.
- Caktimi i indikatorëve për të drejtat e njeriut dhe raportimi në ZKM/ZQM.
- Raportimi në MAPL rreth të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe barazisë gjinore në veçanti.
- Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit në referimin dhe shqyrtimin e ankesave të qytëtarve për shkelje të të drejtave të njeriut nga institucionet komunale.
- Ofrimi i rekomandimeve për të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe barazinë gjinore në veçanti për drejtoritë komunale.
- Përfshirja e përspektivës gjinore në KAB-in 2025-2027 dhe caktimi i prioritëtëve që eliminojnë pabarazitë gjinore në ndarjen e buxhetit komunal.
- Planifikimi i buxhetit komunal nga përspektiva gjinore.
- Analizë gjinore në Kulturë, Rini dhe Sport.
- Analizë Gjinore në Sektorin e Bujqësisë.
- Organizimi i trajnimit për tëknikat e buxhetimit gjinor (pjesmarrës 15 nëpunës civil nga Administrata Komunale), mbështëtur nga UN Women.
- Organizimi i trajnimit "Vlerësimi i ndikimit gjinor në politikat publike komunale" (pjesëmarrës 16 nëpunës civil nga Administrata Komunale), mbështëtur nga UN Women
- Sigurimi i të dhënave statistikore nga këto sfera: zhvillim ekonomik, punësim/mirëqënie sociale, shëndetësi dhe procesin e vendimmarrjes.
- Fuqizimi ekonomik i grave (bizneseve për vetëpunsim) përmes ndarjes së grantëve për zhvillimin e bizneseve në kulturat bujqësore, caktimi i masës affirmative për përfitimin e grantit (pajisjeve/serra).
- Hartimi dhe aprovimi i Planit për Barazi Gjinore për periudhën 2024-2026.
- Hatimi i Planit të veprimit të Mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje 2024-2026.
- Aktivitëtë tjera të vazhdueshme.

## Zyra Ligjore

Gjatë vitit 2025, Zyra Ligjore në bazë të kompetëncave dhe autorizimeve ligjore ka ushtruar funksionet e saj në mbështëtje të veprimtarisë komunës, duke garantuar ligjshmërinë e aktëve administrative dhe mbrotjen e intëresave institucionale.

Gjatë periudhes janar-dhjetor 2025 janë përgatitur dhe shqyrtuar gjithsej 1,210 aktë ligjore, si më poshtë:

- Vendimet të Kryetarit, 442
- Urdhëresa,15
- Kontrata, 60

- Autorizime,15
- Aktë Përcjellëse, 5
- Marrëveshje, 8
- Vlerësime Ligjshmërisë, 522
- Opinion ligjor, 27
- Përgjigje në kërkesë, 103
- Punime në Komisone, 13
- Konsultime të pa numërta.

## Zyra për Avokatin Publik

Gjatë vitit 2025, në cilësinë e Përfaqësuesit Ligjor, kam ushtruar detyrat e mia në përputhje me kompetëncat dhe autorizimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 08/L-227 "Për Përfaqësimin e Institucioneve Shtëtërore në Procedura Gjyqësore, Ndërmjetësim dhe Arbitrazh", si dhe aktët nënligjore përkatëse. Në këtë funksion kam bashkëpunuar vazhdimisht, përmes komunikimit formal dhe joformal, me Zyrën e Kryetarit dhe drejtoritë përkatëse, lidhur me çështje të rëndësishme për institucionin.

Në periudhën e sipërpërmendur, kjo Zyrë ka pranuar gjithsej 118 lëndë të reja, të ndara sipas natyrës: 54 kontëstimore, 18 përmbarimore, 3 administrative dhe 43 penale.

Nga lëndët kontëstimore të pranuara, shumica kanë të bëjnë me rregullim të koeficientëve dhe kompensimin retroaktiv të pagave për shkak të inflacionit (lëndë të DKA-së), ndërsa të tjerat lidhen me kontëstë pronësore, me kompensim dëmi ose borxhi (kryesisht nga shpronësime faktike). Gjatë kësaj periudhe raportuese është vërejtur ende paraqitja e konsiderueshme e padive kolektive gjyqësore, ku si e paditur figuron Drejtoria Komunale e Arsimit, përkatësisht Komuna e Vitisë, lidhur me kompensimin e pagave për shkak të inflacionit dhe atyre jubilare. Sa i përket kompensimeve për arritjen e vitit jubilar, këto padi janë refuzuar nga gjykata. Ndërsa për kompensimin e pagave për shkak të inflacionit, gjykata ende nuk ka vendosur, por pritët të vendosë në favor të paditësve, në përputhje me bazën ligjore të kërkuar dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme.

Ndërkohë, gjykatat nuk kanë vendosur ende për paditë kolektive të paraqitura në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, ku kërkesat kanë qënë pagesa retroaktive e shtësës prej 44 eurosh në muaj, duke filluar nga hyrja në fuqi e Ligjit për Pagat në Sektorin Publik (shkurt 2023) e deri më sot, si dhe rikthimi i të drejtave të fituara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfshirë shtësat për rrezikshmëri në punë dhe shtësën si shërbyes civil. Të gjitha këto kërkesa burojnë nga dispozitat tashmë të shfuqizuara të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, të cilat janë shpallur të papajtueshme me Kushtëtutën nga Gjykata Kushtëtuese. Për këtë arsye, kjo Zyrë ka rekomanduar që zyrtarët publikë të komunës t'i adresojnë këto çështje në mënyrë institucionale tëk organet kompetëntë: Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, si autoritëtë ligjvënëse dhe ekzekutive. Këto institucione mbajnë përgjegjësinë për propozimin, plotësimin, ndryshimin dhe zbatimin e ligjit bazë, në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtëtuese.

Ndërkohë, edhe Asociacioni i Komunave të Kosovës, i mbështëtur njëzëri nga të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, ka nxjerrë qëndrim se duhet të kundërshtohen dhe apelohen të gjitha paditë dhe vendimet gjyqësore që obligojnë komunat të kryejnë pagesa mbi bazën e dispozitave tashmë të shpallura si të papajtueshme me Kushtëtutën. Në këto rrethana, komunat nuk kanë kompetëncë dhe përgjegjësi për vonesat në ndryshimet ligjore, prandaj konsiderohet se atyre u mungon legjitimitëti real pasiv në këto çështje, andaj, në këtë drejtim edhe janë bërë kundërshtimet e nevojshme.

Gjatë vitit 2028 janë pranuar gjithsej 18 lëndë përmbarimore, kryesisht të përfunduara me aktgjykime të formës së prerë. Disa prej tyre janë lëndë të trashëguara, të cilat nuk janë ekzekutuar në mënyrë vullnetare nga Komuna, ndërsa të tjerat lidhen me propozime të bazuara në fatura të papaguara, të pranuara më parë nga zyrtarët komunalë. Në këto rastë, për shkak të mungesës së bazës ligjore dhe për të shmangur shpenzime të panevojshme procedurale, kjo Zyrë nuk ka paraqitur prapësime.

Sa i përket lëndëve penale, janë pranuar gjithsej 43 rastë, të cilat kryesisht lidhen me veprën penale "Ndërtim pa Leje", sipas nenit 359 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ku Komuna paraqitët si palë e dëmtuar. Gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithashtu edhe 3 lëndë administrative.

Duke marrë parasysh volumin e lartë të lëndëve ekzistuese dhe atyre të pranuara gjatë periudhës raportuese, dhe në përputhje me autorizimet që dalin nga Ligji Nr. 08/L-227, janë ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për trajtimin e këtyre çështjeve. Në cilësinë e Përfaqësuesit Ligjor, kjo Zyrë ka paraqitur prapësime dhe ka kundërshtuar të gjitha paditë e përmendura më sipër, duke u mbështetur në një sërë argumentësh juridike, përfshirë: mungesën e kompetëncës lëndore të gjykatës për trajtimin e këtyre çështjeve; mungesën e bazës ligjore për kërkesat për kompensim; si dhe mungesën e legjitimitëtit real pasiv të Komunës në këto procese gjyqësore.

Në varësi të natyrës dhe fazës procedurale të secilës lëndë, janë ushtruar 54 përgjigje në padi dhe personalisht kam marrë pjesë në 192 seanca gjyqësore (duke përfshirë edhe ato të shtyra). Në rastët ku është konstatuar shkelje e dispozitave ligjore, konstatim jo i drejtë apo jo i plotë i gjendjes faktike, janë ushtruar mjetët juridike të rregullta (ankesa dhe përgjigje ndaj ankesave). Në bazë të autorizimit të Kryetarit të Komunës, janë nënshkruar gjithashtu 16 kontrata të dhurimit të pasurisë së paluajtshme, në të cilat Komuna paraqitët si dhuratëmarrëse.

Një ndër problemet kryesore që vazhdon ta ngarkojë Komunën mbetët numri i lartë i padive kolektive të paraqitura nga zyrtarët publik, të cilët, pavarësisht mungesës së kompetëncës dhe përgjegjësisë ligjore të Komunës për kërkesat që lidhen me Ligjin për Pagat, vazhdojnë ta adresojnë atë si palë të paditur. Po ashtu, si sfidë e vazhdueshme mbesin paditë që bazohen në Kontratat Kolektive të nënshkruara më parë nga sindikatat dhe organet qëndrore, për të cilat komunat, megjithëse nuk janë nënshkruese, vazhdojnë të bartin barrën financiare. Kjo situatë paraqët problem të vazhdueshëm për buxhetin e Komunës së Vitisë dhe njëkohësisht ngarkesë për Zyrën e Përfaqësimit Ligjor, e cila, pavarësisht numrit të madh të lëndëve, funksionon vetëm me një zyrtar.

## Zyra për Prokurimit

Zyra e prokurimit ka përgaditur këtë Raport pune për vitin buxhetor 2025, për kryetarin e komunë, bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik duke përmbledh të gjitha aktivitetet e prokurimeve për vitin 2025, në të cilin janë të përfshirë aktivitetet e realizuara të prokurimit deri në lidhjen e kontratve dhe aktivitetet tjera të zhvilluara në këtë periudhë kohore, që po raportojmë.

Përmes këtij raporti do të paraqesim të dhëna e aktivitetet e prokurimit të përmbledhur që janë zhvilluar për ofrimin e shërbimeve,zhvillimin e punëve gjegj.investimeve kapitale dhe furnizimeve me gjëra të ndryshme bazuar në kërkesat dhe nevojat e AK që janë domosdoshmëri për plotësimin e aktiviteteve të komunës, bazuar në kërkesën e njësive shpenzuese dhe për realizimin e shpenzimeve buxhetore, si dhe për plotësimin e kërkesave të njesive buxhetore dhe mbarëvajtje pa pengesa të aktiviteteve të komunës, si dhe për realizimin e investimeve kapitale të planifikuara sipas buxhetit te këtij viti e që është në interes të komunitetit dhe rritjen mirëqenjes qytetare në përgjithësi, punët dhe aktvitetet që zyra e prokurimit i zhvillonpër një vit buxhetor gjegj kalendarik.

Në periudhën kohore Janar- Dhjetor 2025, duke u bazuar në kërkesat e Njësive shpenzuese dhe nevojave të tyre, zyra ka inicuar 36 aktivitete të prokurimit. Duke i ndarë ato sipas kategorive ose llojit të ndara në punë, shërbime dhe furnizime, kemi këto të dhëna;

17 aktivitete me lënde prokurimi Shërbime,
1 aktivitete me lëndë prokurimi Punë dhe
18 me lëndë prokurimi Furnizime.

Nga këto aktivitete, **32** janë permbyll si aktivitete, 2 të tjerat janë anuluar. Ndërsa lloji i procedurave e udhëhequra janë si vijon: 25 raste është përdorë procedura e hapur, 9 raste procedura e kuotimi i çmimit dhe 2 aktivitete procedurë me Vlera minimale.

Prej këtyre aktiviteteve të zhvilluara: 32 aktivitete të prokurimit, janë përmbyll dhe janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave. Ndërsa; **2** aktivitete të prokurimit janë anuluar, një (1) aktivitete janë në procedure të ankimimit.

Zyra e prokurimit përveç këtyre aktiviteteve të shërbimeve, ka realizuar edhe pagesa për Operatoret Ekonomik që kanë kryera punë, furnizime apo shërbime sipas kontratave që kanë me komunën tonë.

Shuma e përgjithshme e shprehur në vlerën e kontratave të lidhura për vitin buxhetor 2025, është **3,799.049.92 €.**

Ndër shërbimet që Zyra e prokurimit është edhe nxjerrja e Urdhërblerjeve pët fillimin e punëve dhe porosin e mallrave dhe shërbimeve dhe procedimi i pagesave, gjatë kësaj periudhe kohore janë lëshuar **800 Urdhërblerje** për pagesën e OE të kontraktuar, duke udhëhequr lëndet për kompletim dhe janë dërguar në Thesar për pagesë gjegjësishte ekzekutim. Zyra e prokurimit ka kryer edhe **72** rekomandime për vendimet e ndryshme të komisioneve për hapje dhe vlersim dhe komisioneve tjera.

Në fund të këtij Raporti duhet vequar se Zyra e prokurimit gjatë viti fiskal 2025, ka ofruar edhe shërbime të ndryshme sipas kërkesave dhe nevojave të të gjithë Njësive shpenzuese, duke ofruar këshilla dhe shërbime profesionale, me qëllimin e të ofrimit të në komunë për bizneset dhe komunitetin e gjërë duke u bazur në respektimin dispozitave ligjore në fuqi por edhe ka pranuar dhe proceduar të gjitha kërkesat që kan ardhur në Zyrë tone

## Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Gjatë vitit 2025, respektivisht periudhës janar-dhjetor, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun (ZIMP) e Komunës së Vitisë, ka qënë e angazhuar në informimin sa më objektiv dhe të shpejtë për zhvillimet aktuale të Institucioneve komunale.

Gjatë kësaj periudhe, ZIMP ka pasqyruar dhe publikuar në Ëeb faqën e komunës viti.rks-gov.net lajme, aktivitët si dhe dokumentë në intëresin publik. Për publikime të aktivitëtëve kemi shfrytëzuar edhe llogarinë në rrjetin social Facebook.

- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, gjatë kësaj periudhe ka publikuar dokumentë mbi procedurat e konkurrimit dhe pranimit në punë.
- Nga procedura e prokurimit janë publikuar dokumentë të shumta përfshirë këtu: 32 kontrata të nënshkruara.
- Janë publikuar gjithashtu edhe 133 Njoftime publike, 30Vendime të Kuvendit Komunal, 49 Vendime të Kryetarit të Komunës, të gjitha draft dokumentët të cilat janë paraparë të shqyrtohen në Komitëtin për Politikë e Financa dhe Kuvendin Komunal.
- Po ashtu janë publikuar edhe disa Plane e Raportë si dhe Dokumentët të cilët ndërlidhën me shpenzimin e parasë publike.
- Një bashkëpunim të ndërsjellët dhe shumë të mirë, kemi pasur me mediat lokale dhe ato qëndrore. Përmes adresave elektronike, gjitha mediave të shkruara, elektronike dhe agjencive të lajmeve u janë dërguar lajmet për ngjarjet nga komuna e Vitisë edhe përmes fotografive.
- Zyra për Informim publik ka përcjell gjitha aktivitëtët e kryetarit të komunës, apo edhe zyrtarëve të tjerë komunal në tërren.
- Pritjen e delegacioneve vendore dhe të huaj në komunën tonë.
- Në kuadër të zyrës janë bërë specifikimet e shpenzimeve për publikime: Shpallje, Konkurse, tëndërë, Njoftime etj.

- Zyra për Informim ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha trajnimet, punëtorit dhe mbledhjet e ndryshme për ndryshimin e pakos ligjore për Transparencë.
- Janë mbajtur edhe dy takimet e rregullta të kryetarit të komunës, njëra në gjashtëmujorin e parë dhe njëra në gjashtë mujorin e dytë.

## Zyrtari i Lektorimit

Gjatë periudhës kohore janar - dhjetor 2025, si lektor Administratës së Komunës dhe i Kuvendit të Komunës së Vitisë kam kryer punë dhe detyra të punës sipas përgjegjësisë zyrtare dhe përshkrimit të detyrave të vendit të punës. Kam lektoruar dokumente zyrtare për Zyrën e Kryetarit, për Kuvendin e Komunës, për drejtoritë, për njësitë dhe zyrat komunale etj.

Gjatë periudhës kohore janar – dhjetor 2025 kam lektoruar këto dokumente:

- Informata vjetore e Kryetarit të Komunës me drejtoritë komunale 2024; Informatë e punës së kryetarit të komunës janar-qershor 2025, Raporti të drejtorive dhe zyrave, plane të punës, dëgjime buxhetore, vendime, procesverbalet e komiteteve, kuvendit marrëveshje ndërkomunale, Informaten e DKA-së për fillimin e vitit shkollor 2024/2025, Plani i veprimit, zjarret verore 2025 etj.
- Procesverbalet e Kuvendit Komunal (mbledhja e XII e 2024 dhe I, II, III, IV, V, VI, VII, VII, VII 2025); Procesverbali nga seanca inaguruese, Deklarata e betimit të kryetarit dhe asamblistëve, Vendimet 23.01.2025(4); Vendimet 24.2.2025(3), Vendimet 20.03.2025(5), Vendim 28.04.2025 (5), Vendimet 21.05.2025(3), Vendimet 26.06.2025(6), Vendimet 29.07.2025(3), Vendimet 25.09.2025(5).
- Komiteti për Komunitete (mbledhja e VII 2024, I, II, III 2025), Informatën e Komunitetit për Komunitete 2025.
- Procesverbalet e KPF-së (mbledhjet I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, IX, X 2025).
- Procesverbalet e KKSB-së (mbledhja e IV 2024 dhe mbledhja e I, II, III 2025).

Gjithashtu kam ndihmuar edhe gojarisht zyrtarët sipas ndonjë kërkese me gojë që më është shtruar dhe kam kryer punë shtesë sipas vendimeve të Zyrës së Kryetarit të Komunës (regjistrimi i pajisjeve dhe inventarit të administratës komunale).

